



A.nr.2081/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Sanie Salihu, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Faton Selmanaj me adresë në Rrugën “*Tahir Kadrijaj*”, nr. 55, Deçan, të cilin me autorizim e përfaqëson Getoar Mjeku, jurist nga Prishtina me adresë në Rrugën “*Enver Maloku*” nr. 15, Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës me adresë: Sheshi “*Zahir Pajaziti*”, nr. 36, Prishtinë si dhe kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji me adresë në Rrugën “*Dervish Rozhaja*”, nr. 12, Prishtinë, me bazë juridike anulimin e vendimeve kontestuese me propozim për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtave, jashtë seancës me datë 08.12.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit Faton Selmanaj me adresë në Rrugën “*Tahir Kadrijaj*”, nr. 55, Deçan, të cilin me autorizim e përfaqëson Getoar Mjeku, jurist nga Prishtina me adresë në Rrugën “*Enver Maloku*” nr. 15, Prishtinë.

II. SHTYHET ekzekutimi i vendimeve të së paditurës së parë- Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, si në vijim:

II.1. Leja ujore për HC Belaja, L.U. 13, 4981/20, i datës 03.11.2020;

II.2. Vendimi për Leje Ujore për HC Deçani, L.U. 14, 4982/20, i datës 04.11.2020;

II.3. Vendimi për Leje Mjedisore për HC Belaja, 19/5837/ZSP, i datës 06.11.2020 dhe

II.4. Vendim për Leje Mjedisore për HC Deçani, 19/5837/ZSP, i datës 06.11.2020, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

III. SHTYHET ekzekutimi i vendimeve të së paditurës së dytë- Zyra e Rregullatorit për Energji, si në vijim:

III.1. Vendimi V_1303_2020, i datës 12.11.2020;

III.2. Vendimi V_1304_2020, i datës 12.11.2020;

III.3. Licensë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC Deçani, Li_49/20, e datës 12.11.2020 dhe

III.4. Licensë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC Belaja, Li_50/20, e datës 12.11.2020, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

Arsyetim

Paditësi-propozuesi Faton Selmanaj nga Deçani, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji, me bazë juridike anulimin e vendimeve kontestuese si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, me propozim për shtyerje të ekzekutimit të të njëjtave.

Gjykata, me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*.

Gjykata poashtu ju referua nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*.

Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, duke shqyrtuar kërkesën për shtyerjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, Gjykata vlerësoi se paditësi/propozuesi ka ofruar argumente të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimeve do t'i sillte dëm banorëve të pjesës në të cilën parashihet të operojnë këto Hidrocentrale, dëm ky i cili vështirë do të riparohej. Gjithashtu Gjykata gjeti se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar.

Meqenëse burimet ujore, qasja e pandërprerë në ujë të pijshëm dhe për ujitje si dhe cilësia e ujit, përbëjnë interes të përgjithshëm shtetëror, gjykata vlerësoi se shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të atakuara deri në vendosjen lidhur me padinë e paditësit, është në interesin publik e që shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Kjo do të shmangte pasojat e mundshme që do të shkaktoheshin në të ardhmen, nëse vendimet e kundërshtuara të të paditurave, në fund të procesit gjyqësor, rezulton se janë marrë në kundërshtim me ligjin.

Këtë vlerësim Gjykata e mbështet në faktin se paditësi ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se bazuar në dispozitat e cekura më lartë, janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi për shtyerjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese derisa Gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara përkitazi me padinë e paditësit e në kuptim të nenit 22 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA).

Në këtë kuptim, Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet nga neni 22 paragrafi 6 lidhur me paragrafim 2 të LKA-së, për shtyerjen e ekzekutimit të vendimeve të kundërshtuara, deri në vendosjen përfundimtare të çështjes.

Ky vendim nuk e paragjykon epilogun përfundimtar të këtij Konflikti administrativ.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e konform nenit 22, paragrafit 7 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2081/2020, datë 08.12.2020



Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.